

Dr. Gabriel Isaac Schor

Z. Gabriel Isaac Shchor ka lindur në Rosario, Argjentinë më 18 janar 1952. Ai është diplomuar në MSc në Ekonomi dhe në Sociologji nga Universiteti i Frankfurtit, Gjermani dhe më pas ka marrë doktoraturën në fushën e Ekonomisë në Universitetin e Trier, Gjermani.

Ai e filloi karrierën e tij në Gjermani si Mësues dhe Asistent Kërkimor në Universitetin e Frankfurtit. Më pas ka punuar në IPC GmbH si Konsulent i Pavarur, Ekspert i Lartë dhe Drejtor Menaxhues, veçanërisht për menaxhimin e projekteve të kompanisë në Amerikën Latine.

Gjatë periudhës 2004-2022 ka qenë pjesë e Bordit Drejtues të ProCredit Holding. Ai ishte përgjegjës për menaxhimin e fushave të ndryshme, si kontabiliteti dhe taksat, mbikëqyrja e raportimeve dhe planifikimi i kapitalit, financimi i grupit dhe thesari, kontrolli, raportimi dhe menaxhimi i të dhënave, marrëdhëniet me investitorët, administrimi dhe përkthimi.

Z. Schor ka pasuruar përvojën e tij profesionale në fushën e mbikëqyrjes bankare në kohën kur ka qenë kryetar / anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Banco ProCredit Ecuador S.A; ProCredit Bank Kosova dhe disa institucione të tjera në Amerikën Latine.

Pas daljes në pension, Z. Schor punon si këshilltar i pavarur i profilizuar veçanërisht në fushat e marrëdhënieve me investitorët, planifikimin e kapitalit, financimin dhe thesarin, kontrollin, raportimin dhe menaxhimin e të dhënave, etj.

Ai flet Spanjisht, Gjermanisht, Anglisht, Portugalisht dhe Frëngjisht.